



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi**

Mbledhja nr. 56  
Prishtinë, më 4.3.2019, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Driton Çaushti, Abdyl Salihu, Arbërie Nagavci, Luljeta Veselaj-Gutaj dhe Albulena Balaj-Halimaj.

**Munguan:** Valentina Bunjaku-Rexhepi, Fidan Rekaliu dhe Verica Çeraniç.

**Përfaqësues të ftuar:** Kujtim Gashi, ministër i MKRS-së, Samir Hoxha dhe Vjollca Aliu.

**Përfaqësues të tjerë:** përfaqësues të KDI- së dhe mediave.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli, si dhe Besart Latifi praktikant.

Për këtë mbledhje u propozua ky

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 25.1.2019, 4.2.2019 dhe 11.2.2019;**
- 3. Raportim i ministrit të MKRS;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

## **2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 25.1.2019, 4.2.2019 dhe 11.2.2019**

Procesverbalet, e mbledhjeve të mbajtura më 25.1.2019, 4.2.2019 dhe 11.2.2019, u miratuan pa vërejtje.

## **3. Raportim i ministrit të MKRS**

Ismajl Kurteshi tha se është praktikë e punës së komisionit që ministrat e linjës të ftohen në fillim të vitit për të paraqitur planifikimet dhe objektivat e tyre dhe në fund vit për të raportuar për realizimin e planifikimet dhe objektivat të parapara në planin e punës.

Ministri Gashi tha se është kënaqësi raportimi për herë të katërt pranë këtij komisioni parlamentar dhe se ky raportim ka të bëjë me disa veprime dhe vendime që kanë ndodhur në tre muajt e fundit. Ai tha se viti 2019 ka filluar me hapjen e diskut Evropa Kreative, ka filluar punën MKRS-ja edhe në Prizren, kemi finalizuar ndryshim dhe plotësimin e disa ligjeve në fushën e kulturës, janë përfunduar konkurset për mbështetje të projekteve kulturore, është hapur konkursi për mbështetjen e botimeve për librin, është mbështetë pjesëmarrja e Kosovës në panairin ndërkombëtarë të librit, kanë filluar procedurat për projektimin e objektit të Teatrit dhe Operës Dr. Ibrahim Rugova, afër hapjes së ndërtimit të kompleksit që do të mbajë emrin ikonës së muzikës Nexhmie Pagarusha dhe jemi në procedurë të renovimit edhe të Teatrit Kombëtarë në Prishtinë.

Ministri Gashi, përveç tjerash theksoi rritjen e buxhetit për këtë vit për të gjitha institucionet e kulturës, me theks të veçantë për filmin. Kosova për herë të parë është paraqitur me një film të financuar nga shteti në njërin prej festivaleve më të mëdha në botë, në Berlinale.

Për sa i përket trashëgimisë kulturore, ministri Gashi tha se mbrojtja, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore vazhdon të jetë një nga prioritetet e ministrisë. Programi i punës është i bazuar në dokumentin Strategjia Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2017-2027 dhe prioritetet e dërguara në kuadër të Planit të punës së Qeverisë. Plani është i shtrirë në pesë objektiva dhe zbatohet nga të gjitha institucionet vartëse të trashëgimisë kulturore.

Tha se është finalizuar draft-Strategjinë për Rini 2019-2023, si dhe Planin e Veprimit për Rini 2019-2021, në kuadër të saj MKRS-ja ka përcaktuar prioritetet dhe gjatë muajit të ardhshëm ky dokument do të aprovohet. Kanë filluar procedurat për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë përmes të cilit do t'i adresojmë të gjitha kërkesat e të rinjve përfshirë edhe çështjen e punës vullnetare dhe organizatave tjera, si dhe këtë ligj do ta harmonizojmë me legjislacionin e BE-së.

Ndërkaq, për prioritetet rreth sportit dhe të arriturat e ministrisë, ministri Gashi tha se prioritetet vazhdojnë të jenë modernizimi i infrastrukturës sportive sipas standardeve ndërkombëtare. Sa i përket ndërtimit të Stadiumit Kombëtarë në komunën e Drenasit, tha se projekti ka filluar të hartohet dhe deri në muajin korrik do të jetë i gatshëm, si dhe renovimi i Stadiumit 'Adem Jashari' nga kategoria II në IV.

Në vijim përmendi përfundimin e dy palestrave sportive në Shtime dhe Rahovec dhe janë në përfundim edhe të palestrave tjera në Kaçanik, Deçan, Skenderaj dhe Istog, për fat të keq palestra e Istogut ka nisur para 13 vitesh dhe nuk është përfunduar, kurse të tjerat para 10 vitesh.

Sa i përket mbështetjes së KOK-ut, Federatave, sportistëve dhe trajnerëve tha se për herë të parë kemi filluar financimin sipas kategorizimit, sipas meritave dhe rezultateve, kjo mbështetje është rritur nga 1 milion e 400 mijë në 3 milionë. Po ashtu tha se xhudistja Majlinda Kelmendi dhe trajneri Driton Kuka përveç shpërblimeve që marrin nga ne, financohen edhe në bazë të pikëve.

Ismajl Kurteshi tha se komisioni ka realizuar një vizitë në KKTK dhe në ditët në vijim planifikon që bashkërisht me përfaqësues të Ministrisë dhe KKTK të realizojë vizita në disa objekte të trashëgimisë kulturore. Nga vizita në KKTK, komisioni ka marrë një raport për projektet e investuara në trashëgiminë kulturore nga MKRS ne periudhën kohore 2008-2018 i cili paraqet një analizë të gjendjes aktuale të trashëgimisë kulturore. Në vazhdim përmendi disa nga konstatimet të cilat kanë të bëjnë me objektet e kulturës si p.sh, Shtëpia e Xhafer Deves në të cilën janë investuar 290 mijë euro dhe ajo është në gjendje të rënde, të njëjtin fat e ka edhe Kulla e Shaban Polluzhës, në të cilën janë investuar 160 mijë euro, e cila është rindërtuar dhe jo rinovuar. Konstatim tjetër përmendi nga të gjeturat e raportit të progresit të vitit 2012 në të cilin thuhet se ka shitblerje të aseteve të trashëgimisë kulturore që është në kundërshtim me ligjin. Konstatimi tjetër kishte të bënte me listën e trashëgimisë kulturore në të cilën gjenden objekte që nuk ekzistojnë. Një tjetër konstatim kishte të bënte me disa projekte që përsëriteshin çdo vit, por pa i shfaqur rezultatet, si dhe realizimi i punimeve nga kompanitë e pa licencuara. Problem tjetër që është evidentuar është mungesa e bashkëpunimit në mes ministrisë dhe KKTK. Në raportin e KKTK konstatohet se gjendja në trashëgiminë kulturore është e rëndë si rezultat i planifikimit jo të mirë të prioriteteve, realizimit ad hoc të projekteve dhe mos vlerësimit të projekteve nga KKTK.

Teuta Haxhiu, në diskutimin e saj tha se mbështet vendimin e ministrisë për përkrahje financiare për Majlinda Kelmendin, si dhe realizimin e projekteve tjera nga kjo ministri. Tha se problem paraqet mosbashkëpunimi i ministrisë me KKTK-në sipas rregullores 01/2016 në të cilën thuhet se KKTK e mbikëqyrë punën e ministrisë gjatë hartimit të listës së objekteve në rrezik të trashëgimisë kulturore, po ashtu problem tjetër paraqet mos funksionalizimi i Këshillit nga ana e Kuvendit. Nga vizita në KKTK thuhet se nga viti 2015 MKRS nuk ka propozuar listën e aseteve për mbrojtje të përhershme dhe në dy raste kur një gjë e tillë ka ndodhur propozimet kanë qenë të paarsyetuara. Çështje tjetër ngriti dukurinë e shitblerjes ilegale të objekteve të trashëgimisë kulturore. Në vazhdim kërkoi sqarim nga ministri se a ka marrëveshje të nënshkruara me Komunitat dhe se cilat obligime nga ato marrëveshje Komunitat nuk po i zbatojnë dhe si qëndron çështja e mirëmbajtjes së objekteve kulturore dhe sportive.

Muferra Sinik, kërkoi sqarim nga ministri sa a është planifikuar projekti për ndërtimin e xhamisë në Kalanë e Prizrenit.

Arbërie Nagavci, në diskutimin e saj kërkoi sqarim nga ministri lidhur me vendimet e Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore për ndërprerjen e punimeve në disa objekte të trashëgimisë kulturore. Sa i përket fondit për rini kërkoi sqarim nga ministri se a ka bashkëpunim me ministrin të linjës siç është Ministria e Inovacionit dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, si dhe cilat janë kriteret për ndarjen e fondit për rini.

Në vazhdim kërkoi sqarim lidhur me propozim vendimin e kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini për Kullën e Sylejman Vokshit, për shfuqizimin e vendimit të mëhershëm me të cilin kjo zonë është e mbrojtur sipas legjislacionit për trashëgimi kulturore. Propozimi i kryetarit të Komunës së Gjakovës me 18 vota për ka kaluar sot në Kuvendin e Komunës, që i bie se është në kundërshtim me konventat dhe legjislacionin në fuqi. Lidhur me këtë tha se në ministri është dorëzuar një kërkesë nga asamblistët opozitarë për të kundërshtuar propozimin e kryetarit të Komunës së Gjakovës, dhe ju si ministri çfarë do të ndërmerni për të mos lejuar që të ndërtohet në zonën e mbrojtur.

Luljeta Veselaj-Gutaj tha se nga vizita e realizuar në KKTK jemi pajtuar për një takim të përbashkët me ministrinë. Në vazhdim ngriti çështjen e krizës financiare që aktualisht gjendet klubi futbollistik KF *Liria* në Prizren dhe kërkoi nga ministri që të shikojë mundësitë e përkrahjes financiare për këtë klub me traditë në elitën e futbollit kosovar. Ajo falënderoi ministrinë për përgjigjen pozitive të MKRS-së në kërkesën e komisionit për të drejtat e njeriut për shndërrimin e Burgut të Prishtinës si Muze.

Driton Çausi, tha se shqetësuese mbetet mos bashkëpunimi në mes MKRS-së dhe KKTK-së, për sa i përket projekteve të trashëgimisë kulturore. Ngriti çështjen e kullës së Shaban Polluzhës e cila sipas tij është ndërtuar në vend tjetër dhe nuk duket ashtu sikurse ka qenë. Tha se ndan shqetësimin me deputeten Arbërie Nagavci për sa i përket Kullës së Sylejman Vokshit dhe kërkoi qëndrimin e ministrit lidhur me parandalimin e ndërtimeve në zonat e mbrojtura të cilat cenojnë trashëgiminë kulturore. Ai tha se raste të tilla të cenimeve të trashëgimisë kulturore kanë ndodhur ndër vite ne të gjitha mandatet dhe kërkoi ndërmarrjen e masave për mos lejimin e ndërtimeve në afërsi të zonave të mbrojtura sipas legjislacionit në fuqi.

Albulena Balaj-Halimaj, në diskutimin e saj, tha se ka qenë propozim i saj që në këtë takim të kemi procesverbalin nga takimi i fundit me ministrin në mënyrë që të bëhet krahasimi i realizimit të punës dhe të arriturave të MKRS-së. Gjithashtu ndau shqetësimin me deputeten Veselaj-Gutaj për gjendjen në klubin e futbollit *Liria* dhe kërkoi nga ministri që shikojë mundësitë ligjore për të mbështetur financiarisht këtë klub.

Kujtim Gashi, sa i përket çështjeve të ngritura për mungesë bashkëpunimi me KKTK-në, tha se çështje e mos bashkëpunimit ka ndodhur ne të kaluarën dhe jo gjatë mandatit tim, e vërteta është se KKTK është jofunksional dhe pritet votimi i tij në Kuvend dhe shpresoj që të emërohen anëtarë profesional dhe jopolitik. Ai tha se ka raste kur MKRS ka dërguar një lëndë në KKTK

dhe nuk kemi marrë përgjigje me vite të tëra dhe MKRS-ja nuk duhet të mbahet peng nga papërgjegjësia e KKTK-së. Sa i përket punës së Inspektoratit për Trashëgimi Kulturor, prej fillimit të punës, ka ndërmarrë 20 masa dhe veprime për institucionet e trashëgimisë kulturore dhe si rezultat i punës së Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore janë ngritur shtatë kallëzime penale. Lidhur me çështjen e ngritur për fondin rinor tha se mënyra e shpërndarjes së mjeteve është transparente dhe sipas kriterëve të përcaktuara me konkurs. Sa i përket çështjes së ngritur lidhur me Kullën e Sylejman Vokshit, tha se MKRS ka një peticion lidhur me këtë rast dhe vendimi i marr nga Kuvendi Komunal i Gjakovës dërgohet në MAPL për të analizuar ligjshmërinë e tij, në këtë rast me që kemi të bëjmë me një vendim që ndërlidhet me trashëgiminë kulturore, MAPL duhet që atë vendimin ta dërgoj në MKRS për çka do të njoftohet edhe Komuna e Gjakovës.

Sa i përket çështjes së ngritur rreth mbështetjes financiare të KF *Liria*, tha se MKRS nuk mbështet financiarisht klubet sportive por vetëm Komitetin Olimpik të Kosovës dhe Federatat Sportive dhe nga ky vit financimi do të bëhet sipas kategorizimit dhe pikëve që marrin.

Sa i përket strategjisë legjislativë MKRS është në procedurë të hartimit të ligjit për sportin përmes së cilit do të rregullohet edhe menaxhimi i objekteve sportive, ligji për rininë përmes së cilit do të trajtohet çështja e punës vullnetare dhe njohja si përvojë e punës dhe çështje tjera në interes të rinisë. Ndërsa lidhur me çështjen e ngritur për shitjet ilegale të objekteve dhe artefakteve tha se nuk ka informata të tilla dhe se shitja e artefakteve është e kundërligjshme.

Vjollca Aliu, lidhur me çështjen e ngritur sa i përket Kullës së Shaban Polluzhes, tha se nuk ka ekzistuar si objekt më parë dhe është dashur të ndërtohet nga fillimi. Sa i përket raportit të KKTK-së dhe se nuk pajtohet me konstatimet e tyre për mosbashkëpunim të MMKRS-së, si dhe raporti përmban dezinformata dhe të pavërteta.

#### **4. Të ndryshme**

Ismajl Kurteshi, njoftoi anëtarët e komisionit lidhur me kërkesën e një grupi të mësimdhënësve të klasave 1-5 për një takim me komisionin, me çka u pajtuan anëtarët e komisionit.

Në vijim propozoi që komisioni në mbledhjen e radhës të diskutoi lidhur me kompensimin e orëve të humbura nga greva e mësimdhënësve, si dhe të formohen grupet punuese për monitorimin e ligjeve.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i komisionit.*

**Kryetari i komisionit,**

-----

**Ismajl Kurteshi**